

LAURA SMAQI

GREMINA E DASHUNIS – ROMANI “MOZAIK” I MUSTAFA GREBLLESHIT

Rreth 70 vjet pas botimit të parë e të vetëm në Shqipëri, “Gremina e dashunis”¹ e Mustafa Greblleshit mbetet roman i panjohur për lexuesin e sotëm dhe i pa trajtuar në studimet tona. Ndoshta fati i autorit përcaktoi dhe atë të veprës, si dhe faktin që romani u botua e ribotua disa herë në Prishtinë por asnjëherë në Tiranë.

Romani doli nga shtypi në vitin 1944 prej shtëpisë botuese “Ismail Mal’Osmani”, por si datë e përfundimit shënohet prej autorit data 1 janar 1942, gjë që do të thotë (nëse i përgjigjet së vërtetës) se autori e ka përfunduar romanin pa mbushur 20 vjeç. Moshë e re e lë gjurmën kudo në roman: në përshkrimin e jetës shkollore, ndjeshmërinë, idealet e personazhit qendror, në debatet shoqërore, mënyrën e strukturimit, po aq sa dhe në praninë e intertekstualitetit e të ndikimeve. Është romani i tretë, ndërtuar në formën e ditarit, gjatë periudhës 1935-1944, mjaft i suksesshëm pas botimit², si dy të parët (Nga jeta në jetë. Pse?! i S. Spases dhe “Sikur të isha djalë” i H. Stërmillit).

Titulli bashkon dy fjalë-çelësa (dashurinë dhe greminën), të pranishme në gjithë shtrirjen e veprës.

*“Ajo (fanatizma – L.S) e bazueme në mentalitetin primitive, copton e mjeron dy zemra njerzish, për t’i katandisë në humnerën e mjerimit të lotëvet.”*³

*“Asht e vërtetë se unë (Margarita – L.S) për të parën here u gremisa në humnerën e dashunis, por kjo më dha një experiencë mjaft të gjatë...”*⁴

Pas letrës që Margarita i dërgon Memlit, nga kemi shkëputur fragmentin e mësipërm, Memli shkruan:

*“Ma në fund ishin hapë edhe qiejt e lumnis sime”*⁵.

¹ M. Greblleshi, *Gremina e dashunis*, Ismail Mal’Osmani Botonjës, Tiranë, 1944.

² Popullariteti i romanit në periudhën që u botua dëshmohej ndër të tjera edhe me përhapjen e gjerë të emrave të personazheve kryesore të tij Memlit e Margeritës në brezin e fëmijëve të lindur në atë hapësirë kohore. I njejtë fenomen ka ndodhur dhe në Kosovë gjatë botimeve dhe ribotimeve të romanit.

³ Po aty, f. 83.

⁴ Po aty, f. 46.

⁵ Po aty, f. 47.

Ferri e parajsja që lidhen e nënkuptohen prej greminës dhe dashurisë, jepen si elemente në gjithë romanin. Gremina, humnera, bashkë me foljen me u gremis, janë pjesë jo vetëm të ligjërimit të Margaritës dhe Memlit, por edhe të personazheve të tjerë: “Në këtë rasë viklima e tragjedis je ti, Memli, shoku ynë mâ i mirë. Ti, me duerët e tua, po **gremisesh**, pa dashitë, në një **humnerë** llahtari prej hah s'ke me mundë me dale mâ”.⁶

Gjithashtu përveç kuptimit figurativ që mbart, gremina është dhe pjesë e peizazhit real ku gjallojnë personazhet e ndonjëherë (si shoku i Memlit, Luli) i japin dhe fund jetës duke e theksuar dramaticitetin që figuracioni, i marrë në vetvete, e ka shumë më të kufizuar⁷. Të njëjtën ide kishte dhe vetë Memli, po plumbi i gjakësit nuk e la.

Bashkë me greminën, (ose humnerën) edhe vdekja vihet pranë dashurisë “Nër shumë romanxa, më janë paraqitë protagonist që kanë përqaftue deri **vdekjen** sepse nuk kanë mundë me fitue **dashuninë** e një vajze. Në fillim jam çuditë dhe një gja e tillë m'ëshë dukë e pabesueshme, por me kohë disa nga shokët e mij që janë kapërthye prej kthetrave të **dashunis**, ma kanë mbushë mendjen se **dashunija** me të vërtetë të çon deri në buzë të **vorrit**”⁸. “Vetëm një gja mund të pohoj me siguri se edhe sikur ta gjejsa, nuk do të arrijsha kurrë deri në thojt e **vdekjes**...”⁹ “Përpara se të kapesha nga grepi i **dashunis**, nuk besojsha kurrë se **dashunija** të çon deri në buzë të **vorrit**, port ash që zembrën ia fala Margaritës – ndonëse ajo nuk e din – do të hidhesha nga aeroplani edhe pa parakadutë!”¹⁰

Në një shoqëri patriarkale e konservatore, megjithë emancipimin e ndjeshëm të viteve '30, rënia në dashuri psikologjikisht mbartte konotacionin e gremisjes, të rrëzimit fatal, i cili kthehej në sinonim të dashurisë.

⁶ Po aty, f. 77.

⁷ “– A e ke pa ndonji herë ti, Memli, luginën ku u rrokullis Luli i gjoë? – Po Margeritë. Kur isha në katund, kemi qëndrue mjaft kohë buzë asaj **gremine** bashkë me shokun fatkeq...Mbas shumë bisedimesh, ra fjala për vdekjen mâ të lehtë, ma të kandshme. Unë shfaqta mendimin tim tue theksue admirimin për një vdekje të pandieshme, të pakuptueshme. Fjala vjen të ngrysesh dhe të mos zgjohesh mâ në mëngjes, por pa ndie dhimbje. Ndërsa shoku kundërshtoi dhe refuzoi me kambëngulje tue ngulmue se mortja mâ e ambël ishte **gremisja** n'atë luginë. Gurët e mprehtë – thonte ai – që neve na duket sikur e coptojnë trupin, e perkëdhelin ambël ndonse e përgjakin; mandej njeriu andrron si nëpër flatrat e një lumnije të pashijueme kurrë dhe të një bote tjetër të panjoftun, deri sa i mbyll syt përgjithmonë, për të mos i hapë kurrë më në botën tone, në këtë botë mashtrimesh”, f. 137.

⁸ Po, aty, f. 17.

⁹ Po aty, f. 18.

¹⁰ Po aty, f. 31.

*
* *

Romani nis me një parathënie të Masar Sopotit*, i cili e konsideron si vepër të një të riu që sjell flladin e mendësisë së re, e që synon krijimin e tërësisë etnike shqiptare, të njësisë kombëtare. Por, për të vepra nuk ndalet këtu, ajo lufton pengimet që ndesh bashkimi mes shqiptarëve, pa dallim besimesh e krahinash, duke theksuar nevojën e reformave në fushën shoqërore, të cilat do ta ndihmonin vendin të ecte drejt përparimit e qytetërimit perëndimor. Epilogu konsiderohet si kurorëzim i natyrshëm i vargut të ngjarjeve, ku vëllavrasja, hakmarrja, kryen vepren e shkatërrimit. M. Greblleshi (i njohur me pseudonimin Liu i Cakut), satirist i mirënjohur i gazetës “Bashkimi i kombit”, sipas Sopotit ka ditur të japë një vepër origjinale, përfutur e zhvilluar në jetën shqiptare, pas një vargu krijimesh të botuara në të përkohshme e fletore, duke e kryer me sukses këtë hap të parë serioz të tij.

Për sa i takon formës ai shkruan: “...shkrimtari i madh rus Dostojevski, në “Ditaren e ngushtë”, ku shënonte të gjitha mendimet e tij lirisht, tue u mârre, një ditë, me vepren e tij të pare “Rinija”, që pat një përhapje shumë të madhe në Rusi, shkruen shumë vjet mbrapa: “Methudha mâ e mire, për një shkrimtâr të ri, që të përpiqet për të fitue simpathinë e pjesës së madhe të publikut lexues, ndahet në dy mënyra: e para asht âjo e shkrimit të njëj veprë, në të cilën, protagonistat kryesorë t’a zhvillojnë gjithë punën e tyne nëpër mjet të letërshkëmbimit dhe, e dyta, ajo e përshkrimit në trajtë ditarjeje” Z. Grëblleshi, pra, ká dijte të zgjedhë, ká mârre atë të ditares. Fillea, për një të ri si Z. Grëblleshi, nuk mund të jetë mâ e mirë.”¹¹

Parapëlqimi i këtij tipi romani, jo vetëm prej Greblleshit po dhe autorëve pararendës lidhet jo thjesht me moshën e re e sprovat e para të shkrimtarëve.

Ndryshe nga romani i Stërmitit që thjesht ndërtohet në formën e ditarit, pa pasur lidhje mes autorit dhe ditar-shkrueses, si romani i Spasses ashtu dhe ai i Greblleshit i kanë më të prekshme lidhjet autor-personazh, duke qenë shumë pranë moshës e rrethanave të personazheve, duke arritur në elemente të caktuara deri në kufijtë e biografisë (Spasse).

* Masar (Mazar) Sopot (1905-1944) është një veprimtar mjaft i njohur i jetës shoqërore dhe politike të viteve ‘20- ‘40, figurë mjaft e rëndësishme e publicistikës dhe kulturës. Kryeredaktor i palës shqiptare të “Gazetës shqiptare” (pjesë e “Gazzetta del Mezzogiorno”) të Barit gjatë viteve ‘30-’40, si dhe hartues e spiker i transmetimeve radiofonike në gjuhën shqipe nga Bari.

¹¹ Po aty, f. 2.

Tre personazhe që ndahen nga jeta në moshë të re, Gjoni me dëshirën e tij, Dija e sflitur nga vuajtjet e sëmundja, Memli i vrarë rastësisht nga gjakësi, por shumë pranë vetëvrasjes. Eksplorimi i tri jetëve si tre këndvështrime e tre zëra që dëshmojnë pamje të ndryshme të një realiteti personal dhe shoqëror, i bën këta romane-ditar mjaft interesantë si në aspektin e njohjes së një faze të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, ashtu edhe të strukturës ndërtimore që dëshmon po ashtu një fazë të zhvillimit historik të romanit, si dhe të ligjëtimeve që i takojnë tipit të romanit-ditar shqiptar të viteve '30-'40.

*
* *

Sa herë është shkruar mbi romanet pararendëse në formë ditari (“Nga jeta në jetë. Pse?!” dhe “Sikur të isha djalë”), është vënë në dukje arsyeja e zgjedhjes së formës së ditarit¹², vëmendja që këta autorë kanë ndaj aspektit social, problemeve të kohës, sentimentalizmi i këtyre veprave, por është anashkaluar

¹² “Romani është shkruar në formë ditari dhe autori është marrë më shumë me **ekspozimin e mendimeve të tij filozofike** se sa me **përshkrimin e ngjarjeve**. Ngjarjet këtu janë vënë në plan të dytë dhe jepen vetëm për t’u dhënë shkas arësytive dhe meditacioneve filozofike të heroit.” N. Jorgaqi, *Romani “Pse?! Dhe fillimet letrare të Sterjo Spasses*, Buletini i U.S.H.T, 1958, nr. 4, f. 138.

“Nuk mund të thuhet se autori e shkruen romanin e vet në formë të ditarit për arsye se ashtu e ka ma lehtë. Asokohe edhe disa shkrimtarë të tjerë shqiptarë shkruajnë romanet e tyre në trajtë të ditarit ose të romanit epistolar. Pikërisht ditari, si trajtë romaneske e shquemjes së përjetimeve të subjektit, i përgjigjej asaj që dojshin të shprehshin autorët e tyre në kohën ndërmjet dy luftavet botënore. Neqoftëse individ i ndiente veten të vetmuem, të shkoqun afërsie e lidhjesh emocionale me shoqëninë, neqoftëse ai ishte i tehuejsuem, atëherë edhe prozatori do të duhej të nisej prej tij, prej mikrokosmosit, e të shkojë nga dukunitë shoqënore e të përgjithëshme njerëzore, drejt makrokosmosit.” R. Qosja, “Jeta e re”, Prishtinë, 1967, f. 1082.

“Romani është shkruar në formë ditari dhe kjo mënyrë ka lejuar që Dija të flasë vetë për jetën e saj. Kështu, nëpërmjet faqeve të ditarit, lexuesi hyn drejtpërdrejt në botën e heroines, njihet me psikologjinë e saj, me vuajtjet e shumta e gëzimet e pakta, merr kontakt me ambientin mbytës, sheh me sytë e tij se si veprojnë ligjet e zakonet e egra në jetën e gruas shqiptare” N. Jorgaqi, *H. Stërmilli, Vepra letrare I*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, f. 25.

“Romani është shkruar në formën e ditarit, që kap një vit. Kjo është formë letrare që krijon iluzionin se e thotë të vërtetën, apo e dëshmon realitetin në letërsi, duke e dëshmuar si shkrim të ditës pa asfarë distance kohore as emocionale me të ndodhurat. ...Vepra e shkruar në trajtë ditari është e përshtatshme për të treguar emocionet e meditimet, por jo edhe të ndodhurat e veprimet.” S. Hamiti, “*Sterjo Spasse*”, *Letërsia moderne*, Vepra letrare 8, f. 715, “Faik Konica”, 2002.

fakti që marrëdhëniet individ-shoqëri shfaqen jo vetëm në mesazhet e forta sociale, por në vetë strukturën e ligjërimit artistik. Debatit shoqëror hyn brenda shkrimit intim. Raportet mes shkrimit intim, përshkrimit poetik¹³ dhe ligjërimit që bashkon publicistikën, retorikën me elementet e saj, programin shoqëror, debatin, propagandën, janë të ndryshme në faqet e veprës, duke i dhënë romanit një strukturë *mozaikale*. Prania e një strukture të tillë kuptohet që në ndërthurjen fillestare, mes romanit në vetë të parë dhe romanit-ditar, e më pas me kalimet e shpeshta nga ligjërimi personal, tipik i ditarit, në atë impersonal, të tipit publicistik dhe oratorik.

Ky tipar, struktura mozaikale, i bashkon të tre romanet-ditar të shkruara në periudhën '35-'44, parë në aspektin e përzierjes së ligjërimeve, regjistrave e tipeve të ndryshme shkrimore. Edhe në biseda normale brenda romanit, ligjërimi kalon nga komunikimi i zakonshëm në instancat oratorike. Shembujt janë të shumtë, por po citojmë përgjigjen që Memli i jep profesorit të frëngjishtes i cili e pyet se çfarë ka dëshirë të studiojë. Pas një vargu përgjigjesh refuzuese për degë të ndryshme studimi, me ton të ngritur emocional, në rolin e oratorit ai në fund pohon: *“Unë Zotni, do të dojsha të ndjek një tjetër fakultet – që për fat të keq nuk asht krijue ende në botë – ku të mësohesh e drejta e jo hipokrizija, ku të specializohesh njeriu me e luftue vdekjen e jo me kontribue për zhvillimin e hovit të saj. Do të dojsha të dal nga dyert e një Universiteti, i cili ka për qëllim t’i paqtojë e t’i vëllaznojë njerzit e jo t’i ndajë e përçajë: ku të mësohesh përparimi dhe jo këthimi në mesjetë; ku të përgatiteshin luftarë për reformën e jetës në përgjithshmeni, për mbarëvajtjen e kolektivitetit e jo përsëritja e respekti i zakoneve t’egra, i burokracive që kërkojnë të mos na lirojnë asnji çast prej hallkës që na kanë vû në fyt.*¹⁴

Ditari “i pastër”, në kuptimin e ligjërimit karakteristik që ka, është vetëm një pjesë e romanit, edhe brenda tij, pjesë të veçanta funksionojnë si tregime të shkurtra ose në miniaturë.

Ditari konsiderohet si fragmentar nga forma, dhe i përqendruar te uni për nga përmbajtja. Autori i ditarit, si objekt vëzhgimi, regjistrimi, analize dhe gjykimi ka veten, për pasojë pyetjet mbi identitetin, ekzistencën, jetën e vdekjen janë shpesh në qendër të ligjërimit intim.

Ditarët fiktivë ose romanet në formë ditari janë konsideruar si shembuj të një etape të evolucionit kulturor. Ditari është një element i formës romanore, ashtu si korrespondenca, me tiparet, vlerat dhe një funksion të

¹³ “Ajo mbramje Maji, ishte me të vërtetë romantike. Yjë të panumurt xixëllojshin e flakrojshin në Qiellin e kristaltë tue u pasqyrue si kandila mbi detin e qetë. Anija rrëshqiste lehtas nër valet e Adriatikut tue lane mbrapa vijën e bardhë të shkumëzue...”, f. 5.

¹⁴ Po aty, f. 134.

veçantë, që janë karakteristika të tij. Formë e hapur, fragmentare, në krijim e sipër, ditari është e kundërta e veprës në formë të mbyllur, logjike dhe të plotë.

Duke qenë në vetvete një shkrim intim, thellësisht personal, ashtu si në jetën reale, edhe në roman ai mund të kthehet në një tekst që qarkullon mes një grupi miqsh, për t'u shndërruar më pas në roman të botuar që i përket një publiku të gjerë. Në fazën e fundit, autori i ditarit ndodhet në një kontekst shkrimi social. Por, në romanet që përmendim, ditarët këtë kontekst e kanë parasysht që në shkrim. (Kujtojmë diskutimet me karakter shoqëror të Zaverit e Dijes, dhe sidomos praninë e fuqishme të autorit në ditarin e Dijes, duke e kthyer gjithë romanin në roman-tezë). Kur e vërteta nuk artikullohet (shqiptohet) tek mjedisi, tek shoqëria, një etalon i ri vlerash artikullohet tek individi që duhet të strehojë normën në hapësirën e tij të brendshme. Interes paraqet forca e tensioneve të ngarkuara emocionalisht që përshkojnë Ditarin, si dhe kërkimi i ekuilibrit të dyfishtë të heroit me veten dhe me shoqërinë.

Me synimin për të dhënë mendime mbi shoqërinë shqiptare, mbi mënyrën e zhvillimit të saj, si edhe ndryshimet e domosdoshme që duhen realizuar për këtë qëllim, në pjesët ku mbizotëron paraqitja e një programi social, ligjërimi merr karakteristikat e argumentimit dhe bindjes, elemente

bazë të retorikës dhe të komunikimit publik¹⁵. Interesante është se argumentimi është i pranishëm edhe kur personazhi kryesor flet me veten¹⁶.

Ligjërimi imtim, karakteristik i ditarit, bashkon përskrime, përjetime, ndjesi të drejtpërdrejta. Në pjesën më të madhe, më shumë se me ditar, duket se ke të bësh me tregime në vetë të parë, pasi dialogët jepen në ligjëratë të drejtë dhe tregohen ngjarje. Pjesët e përjetimeve, reflektimeve jepen në të tashmen, ndryshe nga të mësipërmet që janë në të shkuarën. Një rol mjaft të rëndësishëm, sidomos në përsiatjet e reflektimet, luajnë ndikimet prej autorëve të tjerë, të cilat në roman janë mjaft të ndjeshme. Siç e thamë dhe në hyrje, romani i Greblleshit vjen pas dy romaneve, shkruar në formë ditari, të mirënjohura e të diskutuara mjaft në kohën e botimit, romani “Nga jeta në jetë. Pse?!” i S. Spasses, botuar si përmbledhje e plotë më 1935 dhe “Sikur të isha djalë” i H. Stërmillit, botuar më 1936. Prania e tyre, sidomos i

-
- ¹⁵ - *E ka fajin sundimi ottoman! Vërejtji Gaqi, i cili e largoi themën.*
 - *Mirë u kujtove! – shtoi Andrea tue spjegue gjatë e gjanë për barbarismën e perandorisë otomane dhe shkatrrimin që i solli popullit tone ai sundim errësine. Ai fliste tamam sikur t'i kishte përpara anmiqt shekullorë dhe ma në fund si për të marrë dhe pëlqimin tim m'u drejtue:*
 - *Ç'thue ti Memli, a s'asht kështu?*
 - *Do të kishte qenë shumë ma mirë, sikur Kombi Shqiptar të kishte pasë një besim të vetëm*

fetar. Përse, ç'vjen prej kësaj? – pyeti Shpresa, nërsa Margerita m'i kishte ngulë sytë si të donte me më përpimë të gjallë.

- *Prej kësaj na kanë rrjedhë njimijë të zeza... Kur në një popull, përçamja mbërrin deri*

n'atë gradë sa me e këthye pushkën kundër vëllaut të besimit tjetër, jeta e humb kuptimin...Ah turp e ndoht! Shqiptari që ka adhurue si Perëndi Lirin, për hir të mbeturinave të fanatizmës e kursen gjakun për Nanën-Shqipni! Shqiptari që ka qenë shekuj me rradhë tmerri e sherri i anmiqvet, për hir të kishës e të xhamis duronte zgjedhën e randë të robnins! f. 55-56.

Një ligjërim i tillë, në shkallë të ndryshme është i pranishëm dhe në krijime të autorëve të njohur të prozës gjatë viteve '30, është gjithashtu tepër i ndjeshëm dhe ne romanet pararendëse të tipit ditar të Spasses e Stërmillit.

¹⁶ *Do të përmbahem. Asaj, nuk do t'i jap me kuptue se vuej për te. Asht vuejtje e kotë, pa dobi, pa shpresë. Duhet marrë parasysh pengesat e shumta që na kërcnohen: asht feja që na kanoset si vigan i pamposhtun. E atëherë, ç'kërkoj unë? Po ta diskutojmë çeshtjen mâ me prudencë, na rezulton se – në të vërtetë – pengesat që na ndalojnë për me i a mbërrin qëllimit tone nuk janë dhe nuk duhet të jenë të pakalueshme, ç'ka të bajë që s'jemi të një bese? Ç'hyn në punë besimi kur dy të rij duen ta lidhin fatin e tyne për jetë? Simbas mendimit tim dhe t'atyne që i shikojnë çeshtjet e jetës me objektivitet, për dy vetë që vendosin të shtegtojnë së bashku në jetë, jo vetëm feja, por as formalitetet zyrtare nuk hyjnë në punë. Kur njerzët bashkohen prej zemrave, formalitetet zyrtare e fetare janë kryekëput absurd...”, f. 22.*

romanit të Spasses te “Gremina” është i ndjeshëm në pjesën e ditarit ku Memli përsiat, reflekton mbi jetën.

Duket sikur teksti i “Greminës” luan lojën e pasqyrës për tekstin e “Pse-së” së Spasses. Përmes intertekstualitetit, lidhjes që lexuesi krijon menjëherë me romanin e Spasses, bëhet e mundur prania e Gjon Zaverit dhe Gjençit në romanin e Greblleshit. Në dy romanet shokët e ngushtë të personazheve kryesore, i japin fund jetës. Te Luli duket sikur bashkohen dy personazhe në një, (Luli e Gjoni), e po ashtu të dy bashkë reflektojnë tek Memli me idenë e vetëvrasjes, aq sa ideja e vdekjes në greminë duket se është e sigurt, megjithë dallimet jo të vogla që ai ka me dy personazhet e tjerë. Për ta vënë më në dukje këtë dallim, autori fut artificin e gjakmarrjes, që është një ndër komponentët e romanit dhe rithekson dasinë shoqërore.

Romani i Stërmillit është i pranishëm në një tjetër formë, si vepër që ka luajtur rol në emancipimin shoqëror. Kur bën hartim Memli shprehet: *“Vendosa që të zhvilloj përpara hartimin e Margeritës, mandej ate temin. ...e komentova me pak fjalë subjektin karakteristik të botës sonë Shqiptare, me të cilin Zoti Stërmilli, ia duel në krye revolucionit të tij. Vuna në pah qëllimin që e shtyni auktorin e mirënjoftun të “Sikur t’isha djalë” me prekë e luftue me mjeshtëri të tallë këtë plagë të malcueme të shoqnis sonë dhe në fund e përfundova hartimin tue e qa prap “Dijen” e shkretë, për të cilën kushedi se sa zemra vashash Shqiptare qanë e vajtuen me lemeri”*¹⁷.

Po ashtu, ndërtimi i romanit, që nis me njohje e bisedë, vijon me lexim-paraqitjen e ditarit të një personi të papranishëm, e më pas vijon aty ku rrjedha ishte shkëputur prej ditarit, është i ngjashëm me romanin e Stërmillit. Një procedim i ngjashëm ndodh dhe tek “Sonata e Krojcerit” të Tolstoit, por ndryshe nga romanet e autorëve tanë, nuk bëhet fjalë për ditar, ai që rrëfen ngjarjen është i pranishëm në bisedë. Vlen të ndalemi tek Tolstoi, duke qenë se është ndër autorët e huaj që ka ndikuar jo pak në rininë dhe shkrimtarët e rinj të formuar në Shqipëri gjatë periudhës së viteve ’30-’40. Si në romanin e Spasses edhe në “Greminën e dashunis” leximet e Tolstoit jo vetëm përmenden prej personazheve, por luajnë mjaft rol në frymën dhe bindjet, në atë që në tërësi mund të quhet atmosfera e kohës. Qëndrimi misogyn që personazhe të “Pse-së” dhe “Greminës” kanë, është ndikim i drejtpërdrejtë i leximeve të Tolstoit. Luli e vetë Memli përmendin “Sonatën e Krojcerit”, vepër që ndër të tjera ishte përkthyer prej T. Zavalanit që më 1933, ndonëse njëri si vepër nga duhen nxjerrë mësim, e tjetri si hipotezë mendimi, sepse për Memlin jo gruaja por pamundësia e lidhjes me të është problemi.

Parë në tërësi, vëmendja kryesore i kushtohet marrëdhënieve të individit/vidëve dhe shoqërisë, mundësisë së realizimit personal e shoqëror.

¹⁷ Po aty, f. 129.

Programet me karakter shoqëror, ndërmarrë prej individësh të shkolluar e të emancipuar në veprat e letërsisë së viteve 30 e gjysmës së parë të viteve ‘40, të cilat përmes lexuesit komunikonin me shoqërinë e kohës, e kishin gati të kuptueshëm dështimin që në momentin kur çështja themelore, të cilën synonin të zgjidhnin bëhej papritur pjesë e problematikës së tyre personale¹⁸. Memli, ndonëse është i vetëdijshëm se bashkimi me Margeritën është gati i pamundur shprehet në diskutim në përfundim të shkollës:

- *Vetëm vullneti ynë i pamposhtshëm e ka në dorë shkëlmimin e padijenit, shdukjen e zakoneve t’egra, plogshin e fatalitetit linduer: frymzimin e një jete të re. na duket e vështirë kjo detyrë, por kënaqësija e madhe shpirtnore që dhuron, asht shpërblimi ma i mire, me që asht një misjon përnjimend i naltë qyshse udha që do të ndiqet, asht nga ma të lavdishmet: do të zgjuej në jetë të re një popull që për katër shekuj rresht u dergj n’errsinën ma të tmerrshme; do të mëkambë rishtas një komb të ngujuem, për vetmbrojtje, në jetesën ma patriarkale të kohnavet tona dhe do të kryej mrekullinë e domosdoshme për fisin tone: lidhjen e gjithë shqiptarëve rreth një dëshire të vetme dhe një qëllimi të vetëm....Të dalim vetë, t’i bashkojmë fuqitë tona për t’u ba një trup i vetëm. T’i lame më nj’anë lakmit vetiake, mënit e urrejtjet që shkaktajnë përçamje: të lidhemi me dashuni vëllaznore për t’i arritur të gjitha caqet tona ideale.*¹⁹

Memli dështon si i ri misionar për sa kohë nuk e realizon dashurinë e tij. Misioni shoqëror, arritja e realizimi i tij është i lidhur ngushtë me realizimin personal të personazhit, për këtë arsye si ligjërimi personal dhe ai shoqëror, si regjistri lirik e poetik ashtu edhe ai retorik, bindës e argumentues

¹⁸ Kujtojmë Dodën e Koliqit dhe programin e tij kundër gjakmarrjes.

¹⁹ Paraqitja nga Memli i një programi të tillë, çon më tej çfarë ka thenë më parë një shok i klasës gjatë diskutimeve në grup. “*Fanatizma tashma asht prone vetëm e mentalitetit të të lashtëve. Neve të rijt, me çdo kusht, duhet ta shkëlmojmë, ta dbojmë prej Shqipnije: ajo nuk duhet të ketë vend ma këtu në se duem bashkim e qytetnim...Dhe në të vërtetë rinija e ka zgjedhë rrugën e saj: bashkimin e gjithë shqiptarëve përreth simbolit të lavdishëm të Kastriotit; zhdukjen e zakoneve t’egra dhe plogshin e mentalitetit të ndryshkun; krijimin, mbrenda këtyne megjeve të shenjta, të një shteti mbi baza politike, ekonomike dhe shoqnore krejt modern. Dhe neve – si pjesë e pandashme e kolektivit të kësaj rinije – duhet të bajmë ç’asht e mundun që të mos shkëputemi prej rrugës që na çon drejt lirisë së plotë, bashkimit të përjetshëm dhe dashunisë së singertë vëllazënore. Reforma e përgjithshme asht në dorë të rinisë. Rinija do ta ketë pushtetin. Bota asht e guzmtarëve: guximtare asht edhe rinija jonë!*”, f. 140. Është e dukshme ngjashmëria e shprehjes, ndërtuar me antitezat mes foljeve shkëlmoj, dëboj, zhduk – bashkim, dashuri vëllazërore. Por ndërsa Guri, në formulimin e mësipërm i vë theksin krijimit të një shteti modern, Memli është për frymëzimin e një jete të re e mëkëmbje kombëtare, një fryme që bashkon drejt njësisë.

shkojnë drejt së njëjtës pikë, pikës ku bashkohen dasitë personale e shoqërore: dashurisë. Çelësi në të dy rastet, ose në të tërën që krijon personalja dhe socialja është pranimi i dashurisë si urë bashkuese, si frymë që prej dallimeve krijon plotësinë e harmoninë e domosdoshme për dy njerëz e për një shoqëri të tërë. Titulli e gjithë romani dëshmon se për fat të keq nuk ka urë, por greminë, pamundësi që lidhjet intime e shoqërore të kenë vazhdimësinë në kohë të një udhëtimi të përbashkët në një hapësirë (mjedis shoqëror) që nuk krijon ndërprerje brutale e jetë të çuara dëm.

Jo pa qëllim shprehja propagandistike “si një trup i vetëm”, e përdorur dhe e shpërdoruar ideologjikisht, përmendur dhe në këtë roman, i referohet asaj që vetëm njëjtësimi me tjetrin, dashuria, është në gjendje të realizojë. Konotacioni që shprehja ka në vete, bashkë me atë të dëshirës jo vetëm për një njeri, por për lidhjen e gjithë shqiptarëve rreth një dëshire të vetme, i njehson të dy kahet e dashurisë drejt tërësisë.

Gremina nuk është vetëm përfundimi i dashurisë së Memlit dhe Margeritës, por i Dashurisë si unitet mes njerëzish. (Memli vritet nga shoku i tij, që duke e vranë merr gjakun e të atit.) Këtë na thotë mozaiku i plotë i veprës, pas bashkimit të të gjithë elementeve, e pas fjalisë së fundit: “Larg qyqja vazhdonte kangën e saj vajtimtare”.

SUMMARY

“GREMINA E DASHUNIS” (THE ABYSS OF LOVE) – THE MOSAIC NOVEL OF MUSTAFA GREBLLESHI

The novel “Gremina e dashunis” remains for our reader an unknown and not treated work in our studies for about 70 years, after its first and unique edition in Albania. This novel was published in 1944 from the Publishing House “Ismail Mal’Osmani”. It is the third novel composed in the form of a diary, during the period 1935-1944. After its edition, the novel was a successful work, like two others: “Nga jeta në jetë. Pse?!” and “Sikur të isha djalë”.

Whenever it is written on previous novels in a diary form (it is about the novels created during the years of ‘30), it is stressed the reason of writing in this way, the authors’ opinion about the social aspects of the life and problems of time, the sentimentalism of these works. But it is left out of attention the fact that relations person – society are shown not only in strong social messages. They are shown in artistic structure of speech too. The social debate enters inside of the private debate. The reports between private writing, poetic description and the speech that unites publicity, rhetoric with its

elements, social programme, debate and propaganda, are different on the pages of this work, giving a mosaical structure to the novel.

The presence of such a structure is understood since the initial combination between the novel in the first person and the novel in a diary forme. And afterwards, with frequent passings from the personal speech, which is typical for a diary to the impersonal one, typical for publicity and rhetoric.

